



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
PROKURORII PERGJITHSHEM**

URDHER

Nr. 174 date 05.09.2003

**PER
PASQYRIMIN ME SHKRIM TE QENDRIMIT TE PROKURORIT
NE SEANCE GJYQSORE**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, të ligjit nr. 8737, datë 12.02.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë" në Republikën e Shqipërisë", me synim rritjen e përgjegjësisë së prokurorëve ne seancë gjyqsore,

URDHEROJ:

1. Prokurorët e të gjitha niveleve të prokurorive që marrin pjesë'ae seancë gjyqsore, kërkesat e tyre përfundimtare duhet ti paraqesin \i mënyrë të argumentuar me shkrim, pavarësisht nga objekti i çështjas që shqyrtohet. Në kërkesat e prokurorit jo vetëm duhet të arsyetohet qëndrimi i tij, por me argumenta duhet të rrezohen edhe pretendimete të pandehurit apo të mbrojtësit.
2. Nëse gjatë seancës. nga prokurori bëhen kërkesa dhe jepen argumenta tej atyre që janë shkruar në diskutimin përfundimtar, te kërkohet që ato të shkruhen në procesverbalin e seancës dhe të verifikohet brën<la afateve ligjore, saktësia e procesverbalit gjyqsor për këto argumenla shtesë.
3. Kopje të shkruara të qëndrimeve të prokurorit në seancë. së bashki me shtesat që mund të jenë bërë në seancë, të ruhen në sekretarinë e prokurorisë për një periudhë tre vjecare.
4. Me këtë urdher të njihen të" gjithë prokurorët kundrejt nënshkrimit.
5. Shkelja e këtij urdhëri përbën shkelje të disiplinës ne punë

6. Për ndjekjen e zbatimit të këtij urdhëri ngarkohen drejtuesit e prokurorive si dhe drejtorët e Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm.

7. Ky urdhër hyn ne fuqi menjehere

PROKURORI I PERGJITHSHEM
THEODHORI SOLLAKU



